



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2023:232389  
Datë: 09.02.2024  
Numri i dokumentit: 05309854

PPP.nr.579/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, ne çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit V.H nga V, Rr. “B.K” pn, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Z.K, avokat me seli në P, kundër debitorës K.K.D.F.E.E Sh.a (K)-Distrikti në P, me adresë në bulevardin “B.K”, nr..., ndërtesa ..., kati ..., nr..., lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit në bazë të titullit ekzekutiv – aktgjykimit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga ana e përfaqësues të autorizuar të palës debitorë, kundër Urdhrit për caktimin e përmbartimit P.nr.743/23, të dt.23.08.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat D.B në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.02.2024, mori dhe në të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorës K.K.D.F.E.E Sh.a (K-Distrikti në P, ndërsa Urdhëri për caktimin e përmbartimit P.nr.743/23, i dt.23.08.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat D.B në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat D.B në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit V.H nga V, ka lëshuar Urdhërin për caktimin e përmbartimit nën shenjën P.nr.743/23, të datës 23.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr..., të dt..., përmes të cilit urdhër është obliguar pala debitorë që në emër të borxhit të përcaktuar sipas aktgjykimit të lartëcekur, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 515.25 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, dt.21.10.2014 e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1149,00 €, dhe shpenzimet tjera të procedurës përmbartimore.

Kundër Urdhrit të lartëcekur, brenda afatit të përcaktuar ligjor, prapësim ka paraqitur pala debitorë. paraparë ligjor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 19.07.2023. Në prapësimin e ushtruar ndër tjera pretendohet se kundër aktgjykimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi, debitori ka

ushtruar ankesë brenda afatit ligjor me dt.06.01.2021, por nuk ka pranuar aktgjykimin e shkallës së parë të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm. Mbi bazën e këtij pretendimi, thekson që caktimi i përmbarimit është bërë në kundërshtim me nenin 24 par.1 të LPP-së. Rrjedhimisht, pretendohet se duke mos e pranuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, debitori ka arsye të plotë të kundërshtojë përmbarimin edhe duke u bazuar në nenin 36 pika 1 dhe 2 të LPP-së. Tutje theksohet se i njëjti aktgjykim nuk posedon vulën e plotfuqishmërisë dhe si rrjedhojë nuk ka mundur të plotësohet as me klauzolën e ekzekutimit për të iu nënshtruar përmbarimit siç e përcakton dispozita e lartëcekur. Mbi këtë bazë, pretendohet se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore, gjegjësisht nuk përmban tipare të përmbarueshmërisë në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Bazuar në këto pretendime, ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i palës debitore, të anulohet urdhëri për përmbarim i goditur me prapësim dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 06.10.2023 ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ndër tjera ka theksuar se pretendimet e palës debitore nuk janë të qendrueshme, për faktin se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me dt.24.07.2023 dhe i ekzekutueshëm me dt.17.08.2023, për të cilin fakt debitori ka qenë i informuar, pasi ka pranuar nga ana e përfaqësuesit të kreditorit parashtrësën e dt.07.08.2023, përmes kërkesës për kompensim dëmi, pa ndërhyrje nga ana e përmbaruesit privat. Tutje theksohet se përmbarimi është caktuar në përputhje të plotë me dispozitat e neneve 21 dhe 22 të LPP-së, sepse dokumenti mbi bazën e të cilit është caktuar përmbarimi i plotëson kriteret e kërkuara ligjore, ndërsa bazat e prapësimit në mënyrë taksative janë të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së dhe sipas nenit 69 par.4 të këtij ligji parashihet që baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Mbi bazën e pretendimit se në rastin konkret pala debitore nuk ka ofruar kurrfarë provash me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e parashtruara, ka propozuar që prapësimi i të njëjtës të refuzohet në tërësi si i pa bazuar, ndërsa urdhëri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe vëmendje të pretendimeve të përfaqësuesit të palës debitore, të parashtruara në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të provave të cilat gjenden në dispozicion në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se prapësimi është i pa bazuar, mbi bazën e arsyeve si në vijim:

Dispozita nga 21 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tani e tutje LPP), e cila i referohet bazës juridike për caktimin e përmbarimit, parasheh që: "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve në bazë të të cilave mund të caktohet përmbarimi. Në nënpar 1.1 të këtij neni përcaktohet: "*Dokumente përmbaruese janë: 1.1.vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*". Në këtë funksion, dispozita nga neni 23 par.1 përcakton se: "*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 24 par.1, e cila i referohet përmbarueshmërisë së vendimit gjyqësor, parasheh që "*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbarueshmëria e kreditit për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbarime vullnetare*". Elementet të cilat duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor janë të

përcaktuara saktësisht në dispozitën e nenit 27 par.1 të LPP-së, ku parashihet: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, ndërsa mungesa e njërit prej tyre, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përbarim.

Në rastin konkret, përbarimi është lejuar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, i evidentuar nën shenjë C.nr..., i dt.... Në dispozitiv të të njëjtit është vendosur: *“I. APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësit V.H kundër të paditurës K, me seli në P, lidhur me kompensim dëmi ashtu që: DETYROHET e paditura K, me seli në P, që paditësit V.H nga V të ia kompensojë në emër të dëmit material të shkaktuar me rastin e djegjes së kompjuterit PC Dell dhe monitorit Samsung, në shumë të përgjithshme prej 515.25 euro, me kamatë prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datën 21.10.2014 e gjer në pagesën definitive. II. DETYROHET e paditura K, me seli në P, që paditësit V.H, në emër të shpenzimeve të procedurës të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1149 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm...”* Aktgjykimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm me dt.24.07.2023, ndërsa i ekzekutueshëm me dt.17.08.2023.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, me theks të veçantë aktgjykimit me të dhënat e sipërcekura, erdhi në përfundim se i njëjti i përmban të gjitha tiparet e dokumentit përbarues. Kjo për faktin se aktgjykimi në fjalë paraqet vendim gjyqësor i cili është bërë i formës së prerë, me rastin e parashtrimit të propozimit për përbarim ka skaduar afati për përmbushje vullnetare, ndërsa në dispozitiv është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Nga zbërthimi i aspekteve të tilla, rrjedh se aktgjykimi i lartëcekur i përmbushë të gjitha kriteret e kërkuara ligjore për të shërbyer si bazë për caktimin e përbarimit, në kuptim të dispozitave nga nenet 22 par.1 pika 1.1, 23 par.1, 24 par.1 dhe 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

Pretendimet e palës debitore, të parashtruara përmes prapësisimit, përqendrohen në faktin se ndaj aktgjykimit mbi bazën e të cilit është caktuar përbarimi është ushtruar ankesë, ndërsa pala debitore nuk posedon me aktgjykim i cili e përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe si rrjedhojë nuk ka mundur të plotësohet as me klauzolën e plotfuqishmërisë për të iu nënshtruar përbarimit siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të LPP-së.

Përgjigjen në raport me këto pretendime, Gjykata e ka dhënë në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktvendimi, me ç’rast është konstatuar se aktgjykimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm me dt.24.07.2023, ndërsa i ekzekutueshëm me dt.17.08.2023, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të vulave të protokollit të vendosura në pjesën e sipërme të aktgjykimit. Në funksion të këtij vlerësimi, dispozita nga neni 166 par.1 e LPK-së përcakton që: *“Aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo kundërpadinë.”* Për më tepër, në shkresat e lëndës ekziston edhe një kërkesë e përpiluar nga ana e të autorizuarit të kreditorit, e pranuar në mënyrë protokollare nga pala debitore, përmes së cilës rezulton që kjo e fundit është njoftuar lidhur me faktin se aktgjykimi C.nr..., i dt..., është bërë i plotëfuqishëm me dt.24.07.2023 dhe si pasojë është kërkuar kompensimi i shumave të

përcaktuara në këtë aktgjykim. Mbi këtë bazë, pretendmet e palës debitore nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete dhe në dispozitat në fuqi të LPP-së, dhe si të tilla janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të dispozitës së nenit 73 të LPP-së, u vendos devidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil-  
PPP.nr.579/23, datë 09.02.2024

Gjyqtari,  
Blerand Rrmoku

*KËSHILLË JURIDIKE:* Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 77 të LPP-së është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.